



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	01	11	2012
Nj. Org.	Numër	Shtojca	V era
12	360-15189		



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS(GLLOGOC)
ZYRA E KUVENDIT TË KOMUNËS

12 Nr. 360-15189 dt. 01-11 .2012

Në vështrim të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe në bazë të kapitullit të III, pika 10(10.1, 10.2, 10.3 dhe 10.4) dhe nenit 11 të Programit dhe Udhëzuesit për Banim Social, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogoc) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të mbajtur me dt. 30.10.2012 mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET vazhdimi i kontratave mbi dhënie në shfrytëzim të banesave sociale në Bllokun e I-rë (parë) në Drenasin III, të gjithë përfituesve të këtyre banesave sipas Programit dhe Udhëzuesit për Banim Social edhe për dy vjet, me përjashtim të Raza Shehut nga Dobrosheci e Vjollca Elshanit nga Korrotica e Epërme të cilave ju është dhënë në shfrytëzim banesën nr. 25, në katin e IV, në sipërfaqe prej 59m², sipas Kontratës nr. 360-4972/1 dhe nr. 330/4889 të datës 18.08.2010 si dhe të Sofije Ademit nga Shtutica të cilës i është dhënë në shfrytëzim banesa nr. 21, katë IV, në sipërfaqe prej 56m², sipas Kontratës nr. 360-5262 të datës 18.08.2010.

II. Kontrata për shfrytëzimin e banesave sociale për banesën nr. 6 do të lidhet me Lumnije Durakun bashkëshortja e përfituesit të kësaj banese Rizah Duraku i cili ka vdekur ndërsa kontratën për banesën nr. 23 do të lidhet me Tahir Morinen vëllau i përfituesit të kësaj banese Drita Morina e cila tani është martua dhe nuk jeton më në Drenas III.

III. Kontrata për shfrytëzimin e banesave sociale nuk ju vazhdohet përfituesve sipas pikës një të këtij vendimi nga baza së dy përfitueset e para këtë banesë prej momentit të dhënjës nuk e kanë shfrytëzuar ndërsa përfituesja Sofije Ademi kohë pas kohe e ka shfrytëzuar e atë me dy anëtar në vend që të shfrytëzon me pesë anëtar siq është lidhur kontrata.

IV. Dy banesat sociale të mbetura nga baza të përfituesve të mëparshëm nuk do të ju vazhdohet kontrata për shfrytëzimin e këtyre banesave do të ju ndahen aplikanteve të cilet i plotësojnë kriteret më së miri nga Lista përfundimtare e familjeve përfituese të hartuar nga Komisioni me rastin e ndarjes së këtyre banesave.

V.Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës duke nënshkruar kontratat për shfrytëzimin e banesave sociale me përfituesit me Drejtoratin për Shëndëtesi dhe Mirëqenie Sociale-Sektori për Strehim.

VI.Me këtë Vendim do të njoftohen :Drejtoratet e Komunës së Drenasit,Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë dhe një mbetet për evidencë

VII. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit


Naim Bazaj/

